

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“INNOVATIVE EDUCATION CENTER” SH.P.K**

Sot, më datë 01/01/2024 (dy mijë e njezet e kater), Znj DARINA MINGA , shtetas shqiptar, i datëlindjes 16/05/1973, lindur në Elbasan, dhe banues në Tirane ,Rruga Petro Nini Luarasi njesia bashkiake nr 2 nd 84 , h 1 , person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit me ID H35516088F dhe Z EDVIN DASHI ,shtetas shqiptar i datelindjes 17/07/1989 lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane rruga Edit Durham njesia bashkiake nr 10 nd 13 h 1 person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar mbajtës i kartes se identitetit ID I 90717109R vendosem te themelojme nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

**NENI 1**  
**Themelimi**

Emri i shoqerise eshte "INNOVATIVE EDUCATION CENTER Sh.P.K, Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri INNOVATIVE EDUCATION CENTER" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

**NENI 2**

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë. Eshte fitim prures .fusha e veprimtarise eshte kryesisht ne sherbime dhe ne arsim .Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie eshte veprimtari prodhuese dhe tregtare ne fushen e energjitikes .

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin "INNOVATIVE EDUCATION CENTER " SH.P.K. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i shoqërisë është .Qender kursesh, operim ne fushen e marketingut per te trete,ndertim i faqeve WEB ,grafikë dizajn,trajnime profesional ,si dhe cdo veprimtari tjetër e kesaj fushe te lejuar nga legjislacioni shqiptar .

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në bashkinë Tirane , Adresa Tirane njesia nr 7, rruga Muhamet Gjollësja nd 84 ,hyrja 1 kati I pare .

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 6**

**Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (nje qind mijë) lek, 50 % Ortakja themelues Znj DARINA MINGA dhe 50% ortaku themelues EDVIN DASHI te Shoqërisë Tregtare "INNOVATIVE EDUCATION CENTER " SH.P.K te cilet zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:-  
**Znj.DARINA MINGA** , shtetase shqiptare, i datëlindjes 16/05/1973 lindur në Elbasan, dhe banues në Tirane ,Rruga Petro Nini Luarasi njesia bashkiake nr 2 nd 84 h 1 mbajtës i kartes se identitet me id H35516088F zotërues i kuotave të përbërë nga 50.000(pese dhjete mije) lekë, duke përfaqësuar 50 %,



të kapitalit **Z**, EDVIN DASHI, shtetas Shqiptar i datelindjes 17/07/1989 lindur Vlore ne dhe banues Tirane rruga Edit Durham njesia bashkiake nr 10 shtepi private nr 10 mbajtes i kartes se identitet me id I90717109R zotërues i kuotave të përbërë nga 50.000 (pese dhjete mije) lek, duke përfaqesuar 50% te kapitali te shoqerise .

Kapitali themeltar eshte shlyer plotesisht ne para nga Ortaket me themelimin e Shoqerise. Pergjegjesia e ortakeve shtrihet deri ne shumen e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar

#### **NENI 7 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;  
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 8 Administratori**

Shoqëria administrohet nga 1 Administratore i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë Znj. Darina Minga shtetase shqiptare e datelindjes 16/05/1973 lindur në Elbasan, dhe banues në Tirane, Rruga Petro Nini Luarasi njesia bashkiake nr 2 nd 84 h 1 mbajtes i leter me ID H35516088F shtetas Shqiptar,  
Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, te cili ushtronë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisllacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortaket themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 12**

Ortaket detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëdmojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13**

Mosmarëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa urrejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

### **ORTAKËT THEMELUES**

**DARINA MINGA**



**EDVIN DASHI**

